33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

## **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

## **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Neni 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

## **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39           Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40           Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41           Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42           Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43           Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 613-24-4643-5-2-1/C983

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 120 diteve apo shprehur nominalisht 23.387.04€.</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është <i>[shëno numrin]</i> ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë max 3 dite pas nënshkrimit të kontratës
Përfundimi i punimeve:	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë max 90 dite kalendarike pas nënshkrimit të kontratës, rrespektivisht deri më 16.11.2024. Cdo tejkalim apo vonesë pas kësaj date do të zbatohen penalet sipas pikës 19.1 të KVK-së.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <i>0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës</i> për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit caktohet Armend Aliu ndërsa MDMK caktohet Kushtrim Jashanica.

Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Pagesa	26.2	Pagesat do të bëhen sipas situacioneve të përfunduara ne teren dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura: kontraktuesi do te sjelle sigurimin e garancionit mbi kualitetin e punimeve 10% te vleres se kontrates per 1 vit apo 12 muaj i cili do te perdoret per permirsim te defekteve, Certifikata do të lëshohet OE sipas nenit 33 të KPK, në formën e publikuar nga ana e KRPP-së, <b>CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM</b> të punëve, njëashtu pas përfundimit afatit të kualitetit OE i lëshohet <b>CERTIFIKATË E PRANIMIT PËRFUNDIMTAR</b> , sipas manualit-doracakut të KRPP-së, i publikuar më dt <b>08.07.2024</b> ,
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 2 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 10% të vlerës së kontratës ne forme te sigurimit (sigurimi mbi kualitetin e punimeve) ne afat 1 vjeçar pas <b>CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM</b> .
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

## PARAMASA DHE PARALLOGARIA

### Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Krojmir

Vërejtje: Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Paralogaritura. Punëkryesi duhet t'ia prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim.. Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale. Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshij certifikatat e kualitetit dhe te standardeve.					
NR. 1	LLOJI I PUNËS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Vendosja e shendjave qe eshte duke u punuar gjate ekzekutimit te punimeve	m'	2350.00	1.90	€ 4,465.00
1.2	Gërmimi i dheut i kategorisë së III, IV dhe V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 15km.	m <sup>3</sup>	100.00	3.00	€ 300.00
1.2	Punimi i mbushjes ( satbilizues 0-128 mm) me material guror jokoherent me shtrirje në shtresa dhe ngjeshje duhet te arrijne ngjeshja 45 N/mm2 .	m <sup>3</sup>	100.00	5.00	€ 500.00
2.2	Punimi i bankinave me material guror (0-31.5)mm .Sasia e llogaritur m <sup>3</sup> në gjendje te ngjeshur.	m <sup>3</sup>	170.00	7.00	€ 1,190.00
1.3	Punimi i lëshesave Gypore me diameter Ø 400 mm,ne çmim të përfshihet edhe punimi i kokave sipas detajeve në projekt,me beton te klases C25/30 te deshmuara me ateste.	m'	30.00	20.00	€ 600.00
	Furnizimi me material dhe Punimi i kokave te leshesave ekzistuse sipas detajeve në projekt,me beton te klases C25/30	copë	20.00	50.00	€ 1,000.00
3.2	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-63 mm me trashësi t=10cm,matjet duhet te behen me pllake rrethore qdo 50 m' te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 60 N/mm2 .	m <sup>3</sup>	500.00	10.00	€ 5,000.00

1.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=8-13cm, me ngjeshje me cilindër me vibracion, si dhe pas rrafshimit dhe ngjeshjes, duhet të behen matjet e nenbazes të cilat duhet të arrijnë ngjeshjet 70 N/mm <sup>2</sup> -Te deshmuara me ateste ,matjet duhet të behen me pllake rrethore qdo 50 m'	m <sup>3</sup>	1500.00	12.00	€ 18,000.00
4.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës së asfaltbetonit 0-16mm me trashësi t=8cm në gjendje të ngjeshur. Ne çmim të kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve për këtë pozicion. Te sillen atestet e nevojshme.	m <sup>2</sup>	7100.00	8.50	€ 60,350.00
1.5	Ngritja nivelizimi si dhe pershtatja me nivelin e asfaltin e ri të pushtave ekzistuese. Ne çmim të kalkulohet materiali i nevojshëm me punë dhe kapaku nga materiali metalik për peshë 40 ton. Komplet për copë.	copë	16.00	100.00	€ 1,600.00
	Furnizimi me material ngritja nivelizimi si dhe pershtatja me nivelin e asfaltin të pushtes nga me beton 100x100x100 cm muret e pllaka e betonit të armuar me rrjete fi-12 në qdo 15 cm në dy shtresa në dy drejtime me trashësi 20 cm. Ne çmim të kalkulohet materiali i nevojshëm me punë dhe ujembledhësi nga grila metalike për peshë 40 ton. Komplet për copë.	copë	5.00	200.00	€ 1,000.00
5.2	Hartimi i projektit detal nga ana e kompanisë, pas përfundimit të projektit "ASB Draiëing", duke përfshi të gjitha elementet përcjellëse të niveletës situacioni, gjatësori, tërthoret, Detalet, etj.	m'	2350.00	0.20	€ 470.00

R E K A P I T U L I M I		
AXIS	Përshkrimi	Vlera me TVSH në €
	<b>Totali</b>	<b>94,475.00</b>

## PARAMASA DHE PARALLOGARIA

### Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Kraishte

Vërejtje: Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Paralogaritura. Punëkryesi duhet t'ia prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim..Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale. Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshij certifikatat e kualitetit dhe te standardeve.

NR. 1	LLOJI I PUNËS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.0	Gërmimi i dheut i kategorisë së III, IV dhe V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 15km.	m <sup>3</sup>	54.00	3.00	€ 162.00
2.0	Gërmimi i kanaleve anësore me thellësi 65 cm dhe gjerësi 1.5 m' në çmim të kalkulohet germimi, pastrimi dhe transporti në deponin më të afert në largësi 15km. Kalkulimi për m'	m'	30.00	0.50	€ 15.00
3.0	Rrafshimi i nënbazës me ngjeshje (45MN/m <sup>2</sup> ) me cilindër vibrues.	m <sup>2</sup>	400.00	0.20	€ 80.00
4.0	Punimi i mbushjes ( satbilizues 0-128 mm) me material guror jokoherent me shtrirje në shtresa dhe ngjeshje duhet te arrijne ngjeshja 45 N/mm <sup>2</sup> .	m <sup>3</sup>	32.00	5.00	€ 160.00
5.0	Punimi i bankinave me material guror (0-31.5)mm .Sasia e llogaritur m <sup>3</sup> në gjendje te ngjeshur.	m <sup>3</sup>	7.00	7.00	€ 49.00
6.0	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-63 mm me trashësi t=10cm,matjet duhet te behen me pllake rrethore qdo 50 m' te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 60 N/mm <sup>2</sup> .	m <sup>3</sup>	15.00	10.00	€ 150.00

7.0	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=10cm, me ngjeshje me cilindër me vibracion, si dhe pas rrafshimit dhe ngjeshjes, duhet të behen matjet e nënbazës të cilat duhet të arrijnë ngjeshjet 70 N/mm <sup>2</sup> -Te deshmuara me ateste ,matjet duhet të behen me pllake rrethore qdo 50 m'	m <sup>3</sup>	50.12	12.00	€ 601.44
8.0	Furnizimi dhe punimi i shtresës së asfaltbetonit 0-16mm me trashësi t=8cm në gjendje të ngjeshur. Ne çmim të kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve për ket pozicion. Te sillen atestet e nevojshme.	m <sup>2</sup>	400.00	8.50	€ 3,400.00
9.0	Ngritja nivelizimi si dhe pershtatja me nivelin e asfaltin e ri të pusetave ekzistuese. Ne çmim të kalkulohet materiali i nevojshëm me pun dhe kapaku nga materiali kompozit ose hekur (gize) për pesha 40 ton. Komplet për copë.	copë	1.00	100.00	€ 100.00
10.0	Hartimi i projektit detal nga ana e kompanisë, pas përfundimit të projektit "ASB Draiëing", duke përfshi të gjitha elementet përcjellëse të niveletës situacioni, gjatësori, tërthoret, Detalet, etj.	m'	130.00	0.20	€ 26.00
11.0	<b>Totali me TVSH</b>				€ <b>4,743.44</b>

<b>1 Asfaltimi i rrugës lokale në fshatin Zllakuqan, rruga kryesore e fshatit B=5.0m</b>					
<b>NR. 1</b>	<b>LLOJI I PUNËS</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIMI NJËSI ME TVSH</b>	<b>TOTALI</b>
1	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në trotuar.	m'	950.00	1.90	1,805.00 €

2	Punimi i leshesave Gypore nga betoni me diameter $\varnothing$ 400 mm, ne qmim te perfshihet edhe punimi i tyre ne ne vend kokave sipas detajeve ne projekt, me beton te klases C25/30 te deshmuara me ateste.	m'	30.00	20.00	600.00 €
3	Punimime zhavor i leshesave Gypore nga betoni me diameter $\varnothing$ 400 mm, ne qmim te perfshihet mbushja me material $\varnothing$ 0-31.5 mm shtrirja planifikimi i zhavorit dhe punimi i tyre ne ne vend kokave sipas detajeve ne projekt, me beton	m <sup>3</sup>	12	10.00	120.00 €
4	Frezimi i sfaltit 2-3 cm , ne pjesen ku behet kyqja e rruges, qe lidhet me rrugen kryesore	m <sup>2</sup>	80.00	1.00	80.00 €
5	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-63 mm me trashësi t=10cm, matjet duhet te behen me pllake rrethore qdo 50 m' te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 60 N/mm2 .	m <sup>3</sup>	500.00	10.00	5,000.00 €
6	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja krijimi i ramjeve tethore ne rruge e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t= 8-13cm, me ngjeshje me cilindër me vibracion, si dhe pas rrafshimit dhe ngjeshjes, duhet te behen matjet e nenbazes te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 70 N/mm2-Te deshmuara me ateste	m <sup>3</sup>	700.00	12.00	8,400.00 €
7	Furnizimi dhe punimi i shtresës së asfaltbetonit 0-16mm me trashësi t=8cm në gjendje të ngjeshur. Ne qmim te kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve per ket pozicion.	m <sup>2</sup>	4800.00	8.50	40,800.00 €

8	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e bankinave ne rruge e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm m	m <sup>3</sup>	133.00	7.00	931.00 €
9	Vendosja e shenjzimit horizontal me ngjyr akrylike e thjesht, ngjyra sipas menaxherit, gjersia e vijes 15 cm 3+3+3 e nderprer.	m'	950.00	0.60	570.00 €
10	Vendosja e shenjzimit horizontal me ngjyr akrylike e thjesht, ngjyra sipas menaxherit, gjersia e vijes 15 cm e plot.	m'	1900.00	0.60	1,140.00 €
	Vendosja e shenjzimit horizontal ( zebra) 400 cm x 50 cm, ngjyra e jet dy komponenteshe, ngjyra e nuances sipas udhzimit te menaxherit	m <sup>2</sup>	80.00	13.00	1,040.00 €
11	Ngritja nivelizimi si dhe pershtatja me nivelin e asfaltin e ri te pusetave ekzistuese. Ne qmim te kalkulohet materiali I nevojshem me pun dhe kapaku nga materiali metal për pesha 40 ton. Komplet per copë.	copë	15.00	100.00	1,500.00 €
12	Hartimi I projekti detal nga ana ekompanise,pas perfundimit te projektit "ASB Draiëing", duke perfshi te gjitha elemente percjellse te niveletes situacion, gjatsot, terthor, Detalet, etj.	m'	950.00	0.20	190.00 €
<b>Totali me TVSH</b>					<b>€ 62,176.00</b>

### Paramasa - Ndërtimi i trotuarit në Zllakuqan

Pos	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi/ Njësi	Gjithsej me TVSH
-----	---------------------	--------	-------	-----------------	------------------

2	<b>PASTRIMI I TERENIT</b>				
2.1	Pastrimi I trases betonat dhe gjesendet tjera qe e pengojn ekzekutimin e trotuarit. Qmimi komplet per gjatesi te trases. Shiço trasen para ofertes.	m'	950.00	2.00	1,900.00 €
	shenimi i trasesë, si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit. Ne ket pozicion duhet te pershtatet komplet trasa e trotuarit pa e ndyshuar trupin e rrugës.	m'	950.00	0.50	475.00 €

2.2	Gërmimi i dheut i kategorisë së III- IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 10km.	m <sup>3</sup>	100.00	3.00	300.00 €
2.3	Punimi i bankinave me material guror (0-31.5)mm .Sasia e llogaritur 10cm për gjerësi të bankinave 0.35 m ne gjendje te ngjeshur.	m <sup>3</sup>	25.00	7.00	175.00 €
				Gjithsej 2:	2,850.00 €

3 PUNËT E TROTUARIT DHE BETONIT					
3.1	Punimi i tamponit (30MN/m <sup>2</sup> ) prej material natyror guror siq eshte ne natyrë 0-125mm me trashësi tmax=40cm.Ky material perdoret ne terene jo stabile sipas kerkeses ne tras dhe udhizimeve te organit mbikqyres.	m <sup>3</sup>	380.00	7.00	2,660.00 €
3.2	Rrafshimi i nënbazës dhe ngjeshja (30MN/m <sup>2</sup> ) e saje me cilinder vibrues adekuat per keto lloj punimesh.	m <sup>2</sup>	950.00	0.20	190.00 €
3.3	Furnizimi dhe punimi i tamponit me ngjeshje prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=13cm. dhe ngjeshja (60MN/m <sup>2</sup> )	m <sup>3</sup>	130.00	10.00	1,300.00 €
3.4	Furnizimi dhe punimi i tamponit m ngjeshje prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=6cm.	m <sup>3</sup>	100.00	12.00	1,200.00 €
3.5	Furnizimi, transporti, vendosja dhe betonimi I skajoreve 18/24 .Skajoret do te punohen pergjat asfaltit ekzistues.	m <sup>1</sup>	950.00	11.00	10,450.00 €
3.6	Furnizimi, transporti, vendosja dhe betonimi i skajorëve 8/20 .	m <sup>1</sup>	950.00	9.00	8,550.00 €
3.7	Furnizimi dhe punimi i shtresës së Asfaltbetoni 0-16 mm me trashësi t=7 cm, ne mes tge ansorve ne tretuar dhe ngjeshja sipas standardeve per ket lloj pozicion. Ne qmim te kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve per ket pozicion.	m <sup>2</sup>	950.00	9.00	8,550.00 €
3.8	Furnizimi transporti si dhe vurja ne veper e ujmbledhsave. Ne qmim te kalkulohen: Germimi si dhe mbullimi me zhavor. Gypi betonarme Ø400/500mm me bazament betoni (ose gyp plastike fi-400 l betnuar me thellsi 50 cm rreth tije me beton armuar t-10cm ) dhe ne grill. Grilla metalike 40/40 cm per peshat t=40ton . Gypi i brinjzuar PE SN8 Ø 200mm L= nga 1.6deri 2.4 m'. Koka shkarkuese betonarme C-25/30. Te kalkulohen komplet punet sipas standardeve.	copë	20.00	150.00	3,000.00 €

3.9	Hartimi i projekti detal nga ana e kompanise, pas perfundimit te projektit "ASB Draiëing" duke perfshi te gjitha elemente percjellse te niveletes (situacion, gjatsot, terthor,	m'	950.00	0.20	190.00 €
				<b>Gjithsej 3:</b>	<b>36,090.00 €</b>

<b>REKAPITULIMI</b>		
1	PASTRIMI I TERENIT	2,850.00 €
2	PUNËT E TROTUARIT DHE BETONIT	36,090.00 €
<i>Gjithsej me TVSH:</i>		<b>38,940.00 €</b>

<b>paramasa Instalimi i ndriçimit publik në rrugën fshati Zllakuqan</b>					
Pos	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi/ Njësi	gjithsej me TVSH
1	<b>PUNET PARAPRAKE NE TEREN</b>				
1.1	Shënimi i trasesë para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit.	m'	880.00	0.70	616.00 €
1.2	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në trotuar.	m'	880.00	2.00	1,760.00 €
				<b>gjithsej</b>	<b>2,376.00 €</b>
2	<b>PUNËT E NDRIÇIMIT</b>				
Pos	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi/ Njësi	Gjithsej me TVSH

2.1	<p>Blerja, montimi dhe lidhja e kuadros shpërndarëse elektrike të ndriqimit KESHN te ngjashëm me tipin KRO-RJ(A) prodh.TEP me mbrojtje IP65 i ndërtuar nga Poliesteri me dim : 1200x800x300 mm, me mbyllje hermetike te kapakut dhe me qelës. Kuadri vendoset në bazamentin prej betoni MB20 të përgatitur konform normave teknike. Pajisja që montohet në kuadër duhet të jetë nga materiali që nuk ndryshket kurse të gjitha lidhjet të mbrohen nga korozioni. Kuadri duhet të përmbajë sipas skicës njëpolare të paraqitur në projekt këto elemente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njehsorin elektrik trefazor digjital të tipit MT174-D2A44-MK0Z i paisur me nderrues tarifor 3x230/400V: 50Hz i miratuar nga MTI</li> <li>2. Ndërprerës automatik, 3P, magneto-termik, Tip DPX 100-63A</li> <li>4. Siguresat automatike katërpolare 32A ; - " " " 16A ; - " " " 6A</li> <li>5. Kontaktorët për kyçje automatike të ndriqimit C-44 ,40A,380V</li> <li>6. Releun digjital astrologjik për aktivizimin automatik te ndriqimit</li> <li>7. Voltmetrin për kontrollimin e vlerës së tensionit në faza</li> <li>8. Paket ndërpresin për kapërcim të tregimit të voltmetrit në faza</li> <li>9. Prizën njëpolare për shërbime e servisime brenda kuadrit</li> <li>10. Llambën ndiçuese në brendi të kuadrit</li> <li>11.Zbarrat prej bakri për lidhjen dhe përforcimin e përçuesve në faza, zbarrën e përçuesve të zeros dhe zbarrën e përtokzimit,</li> <li>12. Shkarkuesit katodik dhe zbarrën për barazimin e potencialit.13.Siguresat thikore 63 A ,3 copë;</li> </ol> <p>Të gjithë elementet elektrik duke përfshirë dhe ormanët distributiv duhet të jenë të ndërtuar sipas normave teknike CE dhe IEC. Komplet kuadri shpërndarës elektrik i ndriqimit KESHN deri të shtylla më e afërt. Lidhja e elemnteve duhet te behet ne baze te skemes njekahore e kuadrit shperndares.</p>	copë	1.00	980.00	980.00 €
2.2	Ndërtimi i bazamentit të betonit për KKSH të ndriqimit me dimensione 80x90x30cmx1	m <sup>3</sup>	0.23	250.00	57.50 €
2.3	Hapja e vrimës për bazament të shtyllës, vendosja e gypit Ø 250PE, depërtimi i gypit Ø70 në gypin Ø 250, punët tjera dhe betonimi i bazamentit të shtyllave në cilindrin Beton armes, Ø600/1000 (ne vendet ku eshte thellsia e madhe e kanalit varsisht nga pozita e terrenit Ø600/1000, Ø600/500), (Llogaria e sasisë së betonit në qmim perfshine sasinë e vellimit te cilindrit me lartesi h=0.5m , h=1 m dhe diameter d=0.25m qe mbushet me rërë që i zbritet cilindrit të parë) për shtylla me beton të tipit MB30	copë	35.00	70.00	2,450.00 €

2.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave metalike të ndriçimit të zingura konike me lartësi H=5.5 m $\Phi=115/60$ <b>njëtrajtësishtë e punuar pa saldim të pjesëve</b> , duke përfshirë elementet percjellese ,kapakun,kabëll lidhëse (3x2.5mm <sup>2</sup> ) , siguresë 16 A ,pllakë aralditi,bazën,pllakën për kleme dhe materialit tjetër të nevojshum.komplet me 1 lirë njëkrahëshe me gjatësi 0.7m. <b>Shtyllat duhet të jetë e ndërtuar sipas standardit ISO UN EN ISO 1461 standard i i zingimit. e galvanizuar .shtylla duhet te realizohet me mbjellje</b>	copë	35.00	140.00	4,900.00 €
2.5	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçuese LED 50Ë me llupë.Llampa nga aspekti i dizajnit duhet ti plotësojë standardet Europiane, EN 60598-2-3,EN 55015 DHE TË KETË; Mbrojtëje : IP65(IP66).Qëndrueshmëri pune :≥50000(h) Efikasitet ndriçueshmërisë së LEDIT-IT≥125LM/ë Në 50000 (h/punë) të LEDIT- L70/B20 Temperaturë të ngjyrës:≤5000K Tension pune :90....270V (50Hz) Faktor të Fuqisë:≥0.92 Temperaturë pune:(-40...+60)°C Mbrojtëje nga goditja:IK10 Garancion :≥ 5 vite.	copë	35.00	79.00	2,765.00 €
2.6	Furnizimi dhe montimi i kabllosë furnizuese NAYY -AL-4X35mm <sup>2</sup> ,për furnizim të KESH nga shtyllat e tensionit, trafos 0.4kv tokësore	M <sup>1</sup>	20.00	8.00	160.00 €
2.7	Furnizimi dhe vendosja e kabllos për furnizimin e trupave ndriçuese NAYY (Al) 4x16mm <sup>2</sup> prej KESH-SË tokësore	M <sup>1</sup>	1,100.00	3.70	4,070.00 €
2.8	Mihja e kanalit për shtrirjen e kabllos tokësore me dimenzione 75x50cm si dhe mbulimi pas vendosjes te kabllos në kanal të bëhet me makinat përkatëse.	M <sup>1</sup>	900.00	3.00	2,700.00 €
2.9	Furnizimi dhe vendosja e shiritit të zinguar për tokzim Fe/Zn 25*4mm	M <sup>1</sup>	1000.00	3.0	3,000.00 €
3	Furnizimi dhe vendosja e gypit PVC FI 70 për kablion furnizuese	m <sup>1</sup>	1000.00	1.0	1,000.00 €
3.1	Furnizimi dhe montimi i gypit PVC FI 250 për mbjelljen e shtyllës.	m <sup>1</sup>	35.00	3.5	122.50 €
3.2	Matja e tokëzimit mbrojtës dhe dhënja e atestit të tokëzimit	copë	1.00	350.0	350.00 €
3.3	Montimi i kabllove ne shtyllat e tensionit elektrik	copë	1.00	100.0	100.00 €
3.4	Porositja , furnizimi transporti dhe shtrirja e shiritit paralajmerues "RREZIK TENSIONI" përgjatë gjatësisë së kanalit.	m <sup>1</sup>	900.00	0.4	360.00 €
3.5	furnizimi dhe montimi i Sondave pertokezuese Ø75mm/1500mm	copë	3.00	25.0	75.00 €
3.6	Porositja,furnizimi transporti dhe shtrirja e e rërës se imet në kanalim me dimenzione (0.5x0.75)cm dhe me gjatesi 900m ne nivelin 20 cm.	m <sup>3</sup>	90.00	14.0	1,260.00 €

3.7	Demolim i trotuarit egzistues dhe këthimi në gjendjen e mëparëshme komplet me ngjeshje,zhavorim për vendosjen e kabllos furnizuese .	m <sup>2</sup>	40.00	16.0	640.00 €
3.8	Shpimi i rrugës së asfaltuar për depërtimin e kabllos furnizuese me fi 100 mm dhe vendosja e gypit te çelikt fi 70cm	m <sup>1</sup>	50.00	95.0	4,750.00 €
3.9	prerja e asfaltit dhe kthimi i gjendjes mëparëshme pas vendosjes të kablles me gjersia e asfaltit 50 cm t= 7cm,duke stabilizuar fillimishtë nënbazën me zhavor.Furnizimi ,bartja ,shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-.63mm me trashësi t=20cm,furnizimi ,bartja ,shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31,5 mm	m <sup>2</sup>	20.00	26.0	520.00 €
4	Hartimi i projektit detal nga ana e kompanisë ,pas përfundimit të projektit „ASB Draiëng,, duke përfshirë të gjitha elementet përcjellëse	m <sup>1</sup>	900.00	1.0	900.00 €
			<b>gjithsej</b>		<b>31,160.00 €</b>
	<b>GJITHSEJ TOTALI</b>				<b>33,536.00 €</b>

RIKAPITULIMI		
1	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Krojmir	€ 94,475.00
2	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Kriashte	€ 4,743.44
3	Asfaltimi i rrugës lokale në fshatin Zllakuqan, rruga kryesore e fshatit B=5.0m	€ 62,176.00
4	Paramasa - Ndërtimi i trotuarit në Zllakuqan	€ 38,940.00
5	paramasa Instalimi i ndriçimit publik në rrugën fshati Zllakuqan	33,536.00 €
3	<b>TOTALI</b>	€ 233,870.44

KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN

